

Statistikat e Strukturës së të Ardhurave nga Puna, 2018

Tiranë, 11 Nëntor 2020: Anketa e Strukturës së të Ardhurave nga Puna, 2018 (ASAP 2018) është kryer për herë të parë në vitin 2019, sipas Rregulloreve të Këshillit Europian (KE)¹. Kjo anketë siguron të dhëna të sakta dhe të harmonizuara mbi të ardhurat nga puna me Shtetet Anëtare të BE-së, të cilat përdoren për politikë-bërje dhe qëllime kërkimore. Rezultatet janë të dobishme edhe për krijimin e një strategjie të mirë për menaxhimin e burimeve njerëzore.

Rezultatet e anketës kanë të bëjnë me numrin e të punësuarve me pagë gjatë muajit Tetor 2018, për të gjithë ndërmarrjet me mbi 10 punonjës (seksione B në S të NVE Rev. 2, pa përfshirë seksionin O). Ato sigurojnë të dhëna të strukturuar mbi të ardhurat nga puna, në bazë të karakteristikave kryesore të të punësuarve (gjinia, mosha, niveli i arritjeve, profesioni etj.) dhe ndërmarrjeve (aktiviteti ekonomik, madhësia etj.).

Rezultatet e Anketës së Strukturës së të Ardhurave nga Puna tregojnë që gjatë muajit tetor 2018, të ardhurat mesatare orare bruto për një të punësuar me pagë ishin 293 lekë dhe të ardhurat mesatare mujore ishin 50.735 lekë. Të ardhurat mesatare vjetore gjatë vitit 2018, kanë qenë 595.099 lekë.

Në numrin e përgjithshëm të të punësuarve me pagë 50,6 % ishin meshkuj dhe 49,4 % ishin femra.

Gjatë muajit tetor 2018 hendeku gjinor i të ardhurave mesatare orare ka qenë 6,81 %. Hendeku gjinor i pagave tregon diferencën midis pagës bruto që merr një burrë dhe asaj që merr një grua, dhe kjo diferencë ka qënë më e madhe në Industrinë nxjerrëse, me 34,9 % dhe më e ulët në sektorin e shërbimeve administrative dhe mbështetëse, me – 11,5 %.

Të ardhurat nga puna sipas nivelit arsimor të të punësuarve me pagë, janë më të larta ndër të punësuarit me arsim të lartë, me rreth 392 lekë për orë pune. Meshkujt me këtë nivel arsimor kanë të ardhura nga puna më të larta se femrat. Të ardhurat mesatare për orë pune për meshkujt janë rreth 420 lekë dhe për femrat rreth 372 lekë.

Të ardhurat nga puna janë më të ultat në nivel ekonomie për të punësuarit me pagë me arsim 8/9 vjeçar, rreth 178 lekë për orë. Meshkujt me këtë nivel arsimor kanë të ardhura nga puna më të larta se femrat, të ardhurat mesatare për orë pune për meshkujt janë rreth 193 lekë dhe për femrat rreth 164 lekë.

Hendeku gjinor mbi të ardhurat mesatare për orë pune është më i lartë për të punësuarit me pagë me arsim të mesëm me rreth 21,2 %. Për këta të punësuar, hendeku gjinor i të ardhurave mesatare orare është më i lartë në

¹ Nr. 530/1999, Rregullores së Komisionit (KE) Nr. 1916/2000 (ndryshuar) dhe Rregullores së Komisionit (KE) Nr 1738/2005.

aktivitetin e industrisë nxjerrëse, me rreth 43,3 % dhe më i ulët në aktivitetin e shërbimeve administrative dhe mbështetëse, me rreth - 7,5 % .

Hendeku gjinor mbi të ardhurat mesatare për orë pune është më i ulët ndër të punësuarit me arsim të lartë, rreth 11,5 %. Për këta të punësuar, hendeku gjinor i të ardhurave mesatare orare është më i lartë në aktivitetin e industrisë nxjerrëse me rreth 44,5 % dhe më i ulët në aktivitetin e arteve, argëtimit dhe çlodhjes me rreth -8,8 %.

Fig. 1 Të ardhurat mesatare orare për një të punësuar me pagë sipas aktivitetit ekonomik, gjinisë dhe nivelit arsimor

